



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZË
KRYETARI

Nr. 2271 Prot

Bulqizë më 29/04/2023

URDHËR

Nr. 2271 datë 29.04 2023

PËR

**“VENDOSJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE VENDET E AFISHIMIT
GJATË FUSHATES ZGJEDHORE”**

Bazuar në ligjit Nr.139/2015”Për vetëqeverisjen Vendore” nenit 79 të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor I Republikës së Shqipërisë I ndryshuar ” si dhe udhëzimit nr.6 datë 23,03,2021, te Komisionerit shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

URDHËROJ:

1. Pranë ambjenteve të çdo Njësie Administrative të Bashkisë Bulqizë te kryhet afishimi i materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të KQZ ose të palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor.
2. Në vendet e afishimit subjektet zgjedhore lejohen te afishojnë vetëm materiale të programeve të tyre zgjedhore.
3. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor.
4. Nëse materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore vendosen në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga KQZ dhe urdhërit te Kryetarit të Bashkise Bulqizë, policia Bashkiake merr masa të menjëhershme për heqjen e tyre.

5. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit apo shtyllat e ndriçimit dhe në mjetet e transportit publik.
6. Me zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve dhe Policia Bashkiake.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gezim XHATA

